



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0629

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105, 106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092), në përbërje nga: Vedat Poterqoi - Kryetar, Vjosa Gradinaj Mexhuani - Anëtare dhe Isa Hasani - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga Operatori Ekonomik (OE) “Infosoft System” SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Mirembajtja e 70% te HW te SISH-it per Institucionet Shendetesore“ me nr. të prokurimit: "206-23-1650-2-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria e Shendetesise me datën 13.12.2023, mori këtë:

Vendim

1. Përfundon procesi i shqyrtimit administrativ i filluar sipas ankesës së operatorit ekonomik “Infosoft System” SH.P.K., e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 30.08.2023 (me numër protokolli 2023/0629) për aktivitetin e prokurimit me titull: “Mirembajtja e 70% te HW te SISH-it per Institucionet Shendetesore “ me nr. të prokurimit: “206-23-1650-2-1-1”, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) –Ministria e Shendetesis.
2. Ankuesi lidhur me këto veprime të AK rreth anulimit aktivitetit te prokurimit ne kundërshtim me ligjin, mund ti drejtohet Gjykatës kompetente per mbrojtjen e te drejtave te tij/saj.
3. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik “Infosoft System” SH.P.K.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 08.03.2023, Ministria e Shendetesise, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar njoftimin për kontratë për aktivitetin e prokurimit me titull: “Mirembajtja e 70% te HW te SISH-it per Institucionet Shendetesore” me nr. të prokurimit: “206-23-1650-2-1-1”. Nderkaq me datën

26.05.2023 është publikuar njoftimi mbi vendimin e AK. Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: Shërbime, vlera e parashikuar e kontratës: 720,000.00 €. Hapja e ofertave për këtë aktivitet të prokurimit është bërë me datë 20.04.2022. Pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit që kanë dorëzuar ofertë ka qenë vetëm një (1) OE, dhe AK më datë 26.05.2022, publikon njoftimin mbi vendimin e AK (B58) duke e shpallur fitues OE Infosoft System SHPK në vlerë prej 715,999.98€.

Pas kalimit të afatit ligjor për parashtrim të kërkesave për ri-shqyrtim/ankesave konform afateve ligjore të përcaktuara në LPP gjegjësisht nenit 108/A, autoriteti kontraktues më datë 02.06.2022, duke mos pasur asnjë kërkesë për ri-shqyrtim/ankesë në OSHP, bënë edhe publikimin njoftimit për dhënie të kontratës (B08). Pas publikimit të njoftimit për dhënie të kontratës, AK nuk ndërmerr asnjë veprim për dy (2) muaj e gjysmë, ku më datë 16.08.2023 publikon njoftim për anulim të aktivitetit të prokurimit (B10), duke e përfunduar procedurën e prokurimit me arsyetimin "Anulimi i aktivitetit është kërkuar me shkrim nga ZKA-Sekretari i Përgjithshëm, pas shqyrtimit të lëndës në fazën para nënshkrimit të kontratës. Në bazë të kërkesës së ZKA, është dhënë ekspertizë nga ekspertë të Bankës Botërore në Kosovë dhe bazuar në gjetjet e tyre, Sekretari i Përgjithshëm ka refuzuar nënshkrimin e kontratës dhe ka kërkuar nga ZPP ritenderimin e këtij aktiviteti. Bazuar në ekspertizën e BB, nga ZKA është konstatuar se disa kërkesa kanë qenë në mënyrë të panevojshme kufizuese, duke marrë parasysh edhe faktin se kemi pranuar vetëm një ofertues, ndërkohë që ka pasur shumë OE që e kanë shkarkuar Dosjen e tenderit në eprokurim. Sqarim shtesë ToR dhe kriteret teknike profesionale për këtë aktivitet janë hartuar nga një komision i angazhuar me vendim për këtë projekt. Aktiviteti është tenderuar në bazë të specifikave dhe kriterëve të kërkuara nga Njësia e kërkesës, duke mos ndryshuar asnjë kriter, meqenëse aktiviteti është i natyrës profesionale. AK-MSh gjatë ritenderimit të këtij AP, do të rishikoj kërkesat e tenderit, në mënyrë që të rritet konkurrenca dhe mos të ketë kufizime".

I pakënaqur me vendimin e AK-së, OE ankues "Infosoft System" SH.P.K. me datën 30.08.2023 ka parashtruar ankesë në OSHP, me numër të protokollit 2023/0629, kundër vendimit të Autoritetit Kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër.

Ankesa e OE është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK çdo palë e interesuar mund të parashtrorë ankesë pranë OSHP. Meqë OE ka ushtruar po ashtu kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu dhe nenit 108/A të Ligjit të cituar. Prandaj OSHP konsideron se Ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara dhe e njëjta bie nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 14.09.2023 eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE “Infosoft System” SH.P.K.

I. Refuzohet, ankesa e operatorit ekonomik “Infosoft System” SH.P.K., e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 30.08.2023 (me numër protokolli 629/23) për aktivitetin e prokurimit me titull: “Mirembajtja e 70% te HW te SISH-it per Institucionet Shendetesore “ me nr. të prokurimit: “206-23-1650-2-1-1”, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) –Ministria e Shendetesis.

II. Te mbetet në fuqi vendimi i Autoritetit Kontraktues.

Pohimet ankimore të ankuesit

Pretendimi kryesor ankimor sipas ankesës nr.629/23 ka të bëjë me vendimin e AK-MSH për anulimin e aktivitetit të prokurimit, pas rekomandimit të OE për dhënie të kontratës. OE ankues pretendon se AK e ka bërë anulimin e aktivitetit në kundërshtim me dispozitat ligjore të LPP-së dhe në kundërshtim me rregulloren 001/2022 për prokurim publik neni 42 par.4, ku AK pas rekomandimit për dhënie të kontratë dhe pas skadimit të afatit kohor për parashtrim dhe shqyrtim të ankesave në Njoftimin mbi Vendimin e AK(B58), Autoriteti Kontraktues obligohet të përgatit draftin e kontratës dhe nënshkruaj atë brenda 30 ditëve kalendarike.

Eksperti shqyrtues, pas analizimit të pretendimeve ankimorë dhe shkresave të lëndës, kemi gjetur se AK me 26.05.2023 ka publikuar njoftimin B58 mbi vendimin e AK i nënshkruar nga ZPP. Ndërsa me 02.06.2023 AK ka publikuar B08 për dhënie të kontratës. ZKA i MSH-së me 14.06.2023 i drejtohet KRPP-së me kërkesë për opinion lidhur me kompetencat dhe përgjegjësitë e ZKA-së rreth aktiviteve të prokurimit në raste kur ZKA konsideron se ka shkelje ligjore të LPP-së.

Me 30.06.2023 ZKA i MSH-së pranon përgjigje nga KRPP, kau ndër të tjera thuhet se: *“Bazuar në dispozitat c lart cituara, si dhe në pyetjet c parashtruara në mënyrë shumë të përgjithësuara c që ndërliohen me tërë procesin c prokurimit publik që nga inicimi i aktivitetit të prokurimit c deri në mbylljen c tij. Opinion i KRPP-së është si në vijim: Në rast se Autoriteti Kontraktues zbulon shkelje të dispozitave të LPP-së dhe/ose të legjislacionit dytësor të nxjerrë nga KRPP në bazë të autorizimeve që i janë dhënë me këtë ligj. duhet:*

- a) *ti evidentojë të gjitha shkeljet c mundshme të dispozitave të legjislacionit të prokurimit publik;*
- b) *të bëjë një vlerësim të detajuar të procesit të prokurimit dhe t'i evidentojë shkeljet e mundshme. Nëse AK nuk i ka kapacitetet për ta bërë një vlerësim të tillë të hollësishëm të procesit të prokurimit për t'i evidentuar shkeljet e mundshme. mund të angazhoj ekspert të kësaj fushe për këtë qëllim.*
- c) *pasi t'i evidentojë të gjitha shkeljet c mundshme të legjislacionit të prokurimit publik. Autoriteti Kontraktues duhet të vlerësojë peshën në bazë të rëndësisë së secilës shkelje në përputhje me dispozitat c LPP-së. sepse disa shkelje mund të jenë shumë të rënda me që dëmtojnë jo vetëm procesin e prokurimit por çojnë edhe në lidhjen c një kontrate të dëmshme për autoritetin kontraktues.*

d) të zbatoj masat e nevojshme. varësisht nga rëndësia e shkeljes së evidentuar dhe koha kur është evidentuar një shkelje c tillë. **Masat e tilla mund të janë: ndërprerja e aktivitetit të prokurimit** (neni 62 i LPP-së dhe neni 43 i Rregullores për Prokurimin Publik), Ri-vlerësimi i tenderëve, dhe/ose korrigojimet tjera të mundshme për ti korrigjuar shkeljet e identifikuar në përputhje me LPP-në;

c) është c rëndësishme që të dokumentohen dhe të raportohen shkeljet e evidentuara që dëmtojnë procesin e prokurimit dhe/ose qojnë në lidhjen e një kontrate të dëmshme në mënyrë që autoriteti kontraktues të jetë sa më i përgatitur për të iniciuar një proces hetimor që mund të vije si rezultat. si dhe në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi të ndërmarrë masat ndaj zyrtarëve përgjegjës që më veprim apo mosveprim kanë shkaktuar shkeljet c dispozitave të legjislacionit të prokurimit publik.”.

Pas pranimit të opinionit nga KRPP, në rastin konkret ZKA i Ministrisë së Shëndetësisë me 11.07.20223 i është drejtuar Misionit të Bankës Botërore me kërkesë për angazhim të ekspertëve për vlerësimin e kriterëve të dosjes, nën dyshimin se kriteret janë favorizojnë një OE të caktuar, siç është kërkesa për vazhdimin e garancionit për pajisje ekzistuese si dhe kriteret tjera diskriminuese si pragu/numri minimal i referencave të kërkuara, gjë e cila nuk parashihet me dispozita ligjore në fuqi. Me 01.08.2023 ZKA i MSH-së ka pranuar përgjigje nga Misioni i Bankës Botërore, me cilën përgjigje konfirmohet se kriteret e dosjes së tenderit në pjesën më të madhe kufizojnë konkurrencën dha favorizojnë prodhues dhe operator të caktuar.

Vlen të theksohet se sipas LPP në fuqi, neni 26 par.2-Nënshkrimi i kontratave,“...ko trat t e era të ë ha të a tor et e o tra tu e d h t ë g th h u të n n h u e n në e ë r të a tor et t o tra tu s n a **Z tari e or d n tra , i d e M t i o e a ori eti t et r ë r at s p b** Po ashtu sipas kësaj dispozite “Nënsh et ep tu a as ë t j Nen , o në d e prano në të dre tat he e et ep a tu a në o tratë. **ntratat që n k n n h u e n në p t m ep a a n . he 2. ë t j n ni a ë ë p at e he”.**

Përfundimisht mendimi ekspertit shqyrtues është se kombinimi i kriterëve të dosjes së tenderit si “tërësi” ka kufizuar numrin e OE-ve që mund ti plotësojnë “të gjitha” kriteret. Bindjen tonë për kufizim të mundësisë së pjesëmarrjes së OE-ve të interesuar në këtë aktivitet të prokurimit e forcon edhe më tutje fakti se janë mbi 40 OE që kanë shkarkuar dosjen e tenderit, ndërsa është pranuar vetëm një ofertë nga një OE. Duke pas parasysh gjitha këto që u cekën si më lart, vlerësojmë se kërkesa e ZKA të MSH-së për anulim të këtij aktiviteti, dhe refuzimi i të njëjtit që të nënshkruaj kontratën është në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi të LPP-së neni 62, si dhe dispozitat e nenit 43 par.43.5 pika “i” dhe “j”. Në rastin konkret konsiderojmë se nuk mundet OE ankues e as eksperti shqyrtues i OSHP të jap rekomandim që të “detyrohet” Zyrtari Kryesor Administrativ i një institucioni të nënshkruaj kontratë në një procedurë ku në mënyrë objektive janë konfirmuar shkelje të parimeve bazike të LPP-së dhe pamundësim i pjesëmarrjes për shumicën e OE-ve të interesuar. Megjithëse këtë çështje (pranimin e vetëm një oferte-kufizimi konkurrencës) ZKA ka mund ta ngritë si çështje menjëherë pas hapjes së ofertave, jo të lejoj formimin e komisionit vlerësues dhe rekomandimin për kontratë të OE të vetëm ofertues, prap nuk e ndryshon faktin që nuk mund të detyrohet ZKA të nënshkruaj kontratë në një procedurë ku i njëjti është i informuar se ka shkelje te dispozitave ligjore të LPP dhe rregullave të legjislacionit sekondar. Eksperti shqyrtues e ka parasysh se është tejet e vështirë të krijohet një dosje me kriteret që siguron pjesëmarrje të gjerë të OE-ve, kur kemi të bëjmë me pajisje ekzistuese dhe drejta ekskluzive te OE-ve nga prodhuesit/dilerët, dhe në çfarëdo rrethane

detyrimisht do të ketë kufizime për OE-të që do të mund të ofertojnë, megjithatë ky efekt ndoshta ka mund të zvogëlohet duke ndarë kontratën në disa lote varësisht nga pajisjet dhe teknologjia që do të aplikohen, apo edhe duke lehtësuar kërkesat për punë të ngjashme/projekte komplekse në atë mënyrë që mundëson pjesëmarrjen e më shumë OE-ve. Nëse një gjë e tillë (ndarja në lote) është praktikisht e pamundur, ose lehtësimi i kërkesave ndaj OE-ve (projekte të ngjashme) për të dëshmuar kapacitetin teknik/profesional është i papranueshëm për AK-në, atëherë rezulton (siç dëshmohet me numrin e ofertave) që në tregun tonë është vetëm një OE që mund të plotësojë të gjitha kriteret dhe AK do duhej përdor procedurë të negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë konform neni 35 par.2 pika "i" dhe "ii".

Gjetjet e Panelit Shqyrtues -

Paneli shqyrtues vlerëson se raporti i ekspertizës i përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë panelin dhe të gjitha palët me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Paneli Shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit.

Prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, ndonjë raport dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/saj, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të LPP.

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, Paneli shqyrtues ka administruar si prova: Raportin e Ekspertit Shqyrtues, ankesën e OE infosoft System, Njoftimin mbi vendimin e AK (B58), Njoftimin për Dhënie (B08), Njoftim për anulimin e aktivitetit të prokurimit nr. 214-23-2530-2-1-1.

Paneli Shqyrtues lidhur me Njoftimin e Autoriteti Kontraktues, datës, 16.08.2023 për anulimin e aktivitetit të prokurimit nr. 206-23-651-1-1-1, vëren se AK në faqen tre(3) të Njoftimit për anulimin e aktivitetit të prokurimit, në nenin IV.4 Arsyjeja e anulimit të procedurës së prokurimit publik, ka shënuar këto pika mbi të cilat bëhet anulimi i këtij aktiviteti "Një shkelje e LPP-se ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amendamenti ligjor të kushteve të prokurimit;" dhe tek informacionet shtesë deklaroi se "Anulimi i aktivitetit është kërkuar me shkrim nga ZKA-Sekretari i Përgjithshëm, pas shqyrtimit të lëndës në fazën para nënshkrimit të kontratës. Në bazë të kërkesës së ZKA, është dhënë ekspertizë nga ekspertë të Bankës Botërore në Kosovë dhe bazuar në gjetjet e tyre, Sekretari i Përgjithshëm ka refuzuar nënshkrimin e kontratës dhe ka kërkuar nga ZPP ritenderimin e këtij aktiviteti. Bazuar në ekspertizën e BB, nga ZKA është konstatuar se disa kërkesa kanë qenë në mënyrë të panevojshme kufizuese, duke marrë parasysh edhe faktin se kemi pranuar vetëm një ofertues, ndërkohë që ka pasur shumë OE që e kanë shkarkuar Dosjen e tenderit në eprokurim. Sqarim shtesë ToR dhe kriteret teknike profesionale për këtë aktivitet janë hartuar nga një komision i angazhuar me vendim për këtë projekt. Aktiviteti është tenderuar në bazë të specifikave dhe kriterëve të kërkuara nga Njësia e kërkesës, duke mos ndryshuar asnjë kriter, meqenëse aktiviteti është i natyrës profesionale. AK-MSh gjatë ritenderimit të këtij AP, do të rishikoj kërkesat e tenderit, në mënyrë që të rritet konkurrenca dhe mos të ketë kufizime".

Paneli shqyrtues ka evidentuar dispozitat ligjore për prokurim publik që kanë ndërlidhje me këto veprime të AK. Pasi që neni 62 i LPP mjaftë qartë precizon se në cilat raste mund të përfundojë aktiviteti i prokurimit, po ashtu edhe në nenin 43 të RRPP 001/2022 përcaktohen rastet se kur mund të bëhet ndërprerja e procedurës së prokurimit, ndërsa, arsyeshmëria e AK për ndërprerje

të kësaj procedure nuk parashihet në këtë dispozitë. Sepse AK është i obliguar të që konform dispozitave ligjore ta bëjë ligjshmërinë e secilit veprim dhe këto të verifikohen para inicimit të aktivitetit të prokurimit por edhe në fazat e më të vonshme. Ndërsa, jo në fazën kur publikohet njoftimi për dhënie të kontratës (B08) kur pritet të bëhet edhe nënshkrimi i kontratës nga palët. Edhe interpretimi i KRPP ashtu siç është e cekur në të përgjigjja ndërlidhet me tërë procesin e prokurimit publik që nga inicimi i aktivitetit të prokurimit e deri në mbylljen e tij. Ndërsa, me publikimin e njoftimit për dhënie të kontratës nga ana e AK, aktiviteti i prokurimit konsiderohet i mbyllur sepse kalon edhe koha për ankesë në AK dhe OSHP, dhe këto veprime të AK janë pas mbylljes së aktivitetit të prokurimit.

Me publikimin e njoftimit mbi vendimin e AK (B58) dhe skadimin e afateve kohore për parashtrim të ankesave, pastaj me publikimin e njoftimit për dhënie të kontratës (B08) për panelin shqyrtues konform dispozitave ligjore konsiderohet aktiviteti i mbyllur, ashtu siç e përcakton edhe neni 10 paragrafi 3, pika (i) i LPP, citat "aktiviteti i prokurimit konsiderohet i mbyllur (i) në datën e publikimit të njoftimit për dhënien e kontratës ose njoftimit mbi rezultatet e konkursit të projektimit", si dhe nenin 42.4 të RRPP nr.001/2022.

Në nenin 42.4 i RRPP nr. 001/2022, e obligon AK që, citat: "*Pas skadimit të afatit kohor për parashtrim dhe shqyrtim të ankesave në Njoftimin mbi Vendimin e AK(B58), Autoriteti Kontraktues obligohet të përgatit draftin e kontratës dhe nënshkruaj ate brenda 30 ditëve kalendarike*", ashtu sikurse e obligon edhe neni 24, paragrafi 2 i LPP "*Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj*".

Andaj, paneli shqyrtues bazuar në nenin 10 të LPP, lidhur me nenin 42.4 i RRPP nr. 001/2022, vlerëson se kjo çështje është përfunduar dhe rrjedhimisht vendosi si në pikën 1 të dispozitivit.

Kurse ankuesi për realizimi e të drejtës së tij/saj mund ti drejtohet institucioneve kompetente.

Prandaj duke vepruar mbi bazën e parimeve themelore të procedurave për shqyrtimin e prokurimit, të cilat mes tjerash, janë sanksionuar në mënyrë të veçantë me dispozitën e nenit 104, të LPP dhe njëherësh duke i analizuar shkresat e kësaj lënde në relacion me faktet dhe rrethanat e përshkruara si më sipër, e posaçërisht duke i kushtuar kujdesin e duhur po ashtu dhe natyrës dhe qëllimit të pretendimeve ankimore, Paneli Shqyrtues mori në konsideratë të gjitha pohimet e ankuesit, aktet dhe veprimet e ndërmarra nga AK, raportin e ekspertit shqyrtues dhe i analizoi me kujdes të gjitha shkresat e kësaj lënde dhe konsideron se shqyrtimi i kësaj ankesë bie jashtë autorizimeve të përcaktuara ligjore.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues
Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - MINISTRIA E SHËNDETËSISË**
- **OE - Infosoft Systems SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: